

KËSHILLA

Shejhu: Ali Abdurrahman El-Hudhejfi

22/7/1424H

Falenderimi i takon Allahut, Dëgjuesit, Shikuesit, Njohësit të gjithçkaje i cili ka përfshirë gjithçka me mëshirën e Tij. E falenderoj Zotin tim, tek Ai pendohem dhe i kërkoj falje. Dëshmoj se nuk ka të adhuroar tjetër përveç Allahut, të Lartit e të Plotfuqishmit i cili nuk ka shok dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij. O Allah, fale, përshëndete dhe begatoje robin dhe të dërguarin Tënd, Muhammedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Frikësojuni Allahut dhe tregohuni të devotshëm ndaj Tij sepse me të vërtetë të fituarit janë ata që i frikësohen dhe tregohen të devotshëm ndaj Tij. O ju muslimanë, këshilla më e mirë për zemrat dhe pastrimi më i mirë për shpirtrat janë ajetet e Kur'anit ose hadithet e të dërguarit të Allahut. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"Ai është që tek të pashkolluarit (arabët) dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ju lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe mençurinë (Sheriatin) edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme."** (El-Xhumuah: 2) Dëgjoni dhe hapini zemrat dhe mendoni pak rreth disa fjalëve të pakta të zotërisë së njerëzimit, Muhammedit alejhis-selam, të cilat kanë përmbledhur të gjithë fenë islame si dhe gjithë mirësitë e fesë dhe dynjasë. Këto fjalë të pakta nuk kanë lenë asnjë mirësi pa përfshirë dhe nuk kanë lenë asnjë të keqe veçse kanë paralajmëruar prej saj. Pejgamberi ynë alejhis-selam fliste me fjalë madhështore, përmbledhëse por të pakta të cilat përmbanin kuptime të shumta, të dobishme dhe madhështore. Ndodh që një fjalë e vetme e tij të përfshijë të gjitha mësimet e Islamit, prej këtyre fjalëve është: **"Bamirësia (Ihsani) është ta adhurosh Allahun sikur ti e shikon Atë..."** Transmetoi Muslimi nga hadithi i Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

Ai gjithashtu ka thënë: **"Mirësia është çdo gjë tek e cila të qetësohet vetja dhe zemra ndërsa gjynahu është çdo gjë që ndikon tek vetja, lëviz në gjoks dhe urren që ta dinë njerëzit, edhe nëse për të të japin fetua njerëzit."** Transmeton Ahmedi dhe Muslimi një pjesë të tij. Prej fjalëve të tij të dobishme dhe të begatshme është edhe: **"Feja është këshillë, feja është këshillë, feja është këshillë."** Thamë: Për kë o i Dërguari i Allahut? Tha: **"Për Allahun, për librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për prijësat e muslimanëve dhe për njerëzit e thjeshtë."** Transmetoi Muslimi nga hadithi i Temijm Ed-Dari (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Ky hadith tregon se feja është vetëm këshillë prandaj kush e ka këshillimin cilësi të tij me të vërtetë që e ka plotësuar fenë ndërsa kujt i është privuar këshillimi, atij i është mangësuar feja në vartësi me mangësinë që ka në këshillim. Këshillë do të thotë: Të plotësosh të drejtat e atij që këshillon duke e dashur me sinqeritet atë, të drejtat janë fjalë, vepra dhe dëshira të zemrës. Këshillimi është prej cilësive të pejgamberëve, të dërguarve dhe të besimtarëve ndërsa mashtrimi dhe ngritja e kurtheve është prej cilësive të kafirëve

dhe munafikëve. Allahu i Madhëruar duke përmendur Nuhin alejhis-selam ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"Unë ju kumtoj juve shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Zoti im çka ju nuk dini."** (El-A`raf: 62) dhe ka thënë për Hudin alejhis-selam: (Ky është komentimi i ajetit) **"(Jam dërguar) Që t'ju komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju."** (El-A`raf: 68) dhe ka thënë për Salihun alejhi-selam: (Ky është komentimi i ajetit) **"O populli im, unë ju komunikova dërgesën e Zotit tim, ju këshillova sa munda, por ju nuk i doni këshilluesit."** (El-A`raf: 79) dhe ka thënë për Shuajbin alejhis-selam: (Ky është komentimi i ajetit) **"O populli im, vërtet unë ju komunikova porositë e Zotit tim, ju dhashë këshilla, e si të brengosem për një popull jobesimtar."** (El-A`raf: 93) Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"Nuk është ndonjë mëkat për të dobëtit, as për të sëmurët, e as për ata që nuk kanë me çka të pregatiten, kur ata këshillojnë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij..."** (Et-Teube: 91) Nga Xherijr ibn Abdilah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se ka thënë: *I dhashë besën të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ue sel-lem për të falur namazin, për të dhënë zekatin dhe për të këshilluar çdo musliman.* Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se pejgamberi alejhis-selam ka thënë: **"Të drejtat e muslimanit ndaj muslimanit janë gjashtë: Nëse e takon atë jepi selam, nëse të thërret përgjigju atij, nëse të kërkon këshillë këshilloje atë, nëse teshtin dhe falenderon Allahun thuaj atij jerhamukallah, nëse sëmuret vizitoje dhe nëse vdes pusoje xhenazen e tij."** Transmeton Muslimi. Nga Xhubejr ibn Mut'im (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmeton se Pejgamberi alejhis-selam ka thënë: **"Tre gjëra nuk mund t'i ketë smirë zemra e muslimanit: veprimi i punëve vetëm për hir të Allahut (sinqeriteti), këshillimi i prijësave dhe qëndrimi bashkë me xhematin e muslimanëve."** Transmeton Ahmedi dhe Ibn Hibbani. Kuptimi i hadithit është se këto tre gjëra e rregullojnë zemrën dhe e pastrojnë atë nga mashtrimi, smira dhe nga çdo gjë tjetër e keqe. Njerëzit më të mirë të këtij populli janë ata që prej cilësive të tyre kanë edhe këshillën për Allahun, librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për prijësat e muslimanëve dhe për njerëzit e thjeshtë. Ebu Bekër El-Muzeni (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) nuk kishte më shumë se sahabët e tjerë as agjërime e as namaz por kishte diçka në zemrën e tij më shumë se të tjerët. Kishte në zemrën e tij dashurinë për hir të Allahut dhe këshillën për krijesat e Tij.* Ibnul-Mubarek (Allahu e mëshiroftë!) u pyet se cila është puna më e mirë dhe tha: *Këshilla për hir të Allahut.* Ma'mer (Allahu e mëshiroftë ka thënë) ka thënë: *Njeriu që të këshillon ty më mirë është ai që i frikësohet Allahut për ty.* Disa prej selefëve kanë thënë: *Kush e këshillon vëllanë e tij vetëm për vetëm, ai me të vërtetë e ka këshilluar ndërsa kush e këshillon atë përpara njerëzve me të vërtetë që e ka poshtërruar.* Kuptimi i këshillës për Allahun është adhurimi i Tij pa i shoqëruar Atij askënd, duke qenë i singertë në atë adhurim dhe duke pasuar Muhammedin sal-lallahu alejhi ue sel-lem, duke iu nënshtruar Atij dhe njëkohësisht duke e dashur Atë. Duke mos shoqëruar ndonjë tjetër veç Tij në lutje, në kurban, në zotim, në kërkimin e ndihmës, në kërkimin e mbrojtjes, në mbështetje, në shpresë, në frikë dhe në çdo lloj tjetër të adhurimit duke iu përmbajtur thënies së Allahut të Madhëruar: (Ky është komentimi i ajetit) **"Adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asnjë send..."** (En-Nisa: 36) Ai gjithashtu ka thënë: (Ky është

komentimi i ajetit) **"Dhe se vërtet xhamitë janë vetëm për (të adhuruar) Allahun prandaj mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun!"** (El-Xhinn: 18) Këshilla për Allahun e Madhëruar është besimi në cilësitë e Tij ashtu si e ka cilësuar Ai veten e Tij dhe ashtu si e ka cilësuar Atë i Dërguari i Tij alejhis-selam duke mos i krahasuar ato me cilësitë e krijesave si dhe duke mohuar prej Tij çdo gjë që nuk i përshtatet Atij por pa mohuar cilësitë e Tij të vërteta. Duhet të besojmë se vetëm Ai është Krijuesi dhe drejtuesi i gjithësisë në dynja dhe Ahiret duke zbatuar kështu thënien e Tij: (Ky është komentimi i ajetit) **"Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi..."** (El-A`raf: 54) Duhet që të afrohem tek Ai duke vepruar çdo detyrë dhe çdo gjë të pëlqyer dhe duhet të largohemi nga çdo haram. Kush i kryen këto detyra ndaj Zotit të tij me të vërtetë që ka këshilluar për Krijuesin e tij. Hasen El-Basri transmeton në hadithin mursel se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: **"Sikur ndonjëri prej jush të kishte dy robër, njëri prej tyre i bindej atij kur e urdhëronte, e mbante amanetin dhe këshillonte për të kur ai mungonte. Ndërsa tjetri e kundërshtonte kur ai e urdhëronte për diçka, nuk e ruante amanetin dhe mashtronte kur i zoti i tij mungonte. A janë këta dy robër njësoj?"** Thanë: Jo. Tha: **"Edhe ju kështu jeni tek Zoti juaj."** Transmeton Ibn Ebi Dunja. Ebu Uname (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmeton prej Muhammedit alejhis-selam se Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Gjëja më e mirë me të cilën më adhuron rob i Im është këshilla për Mua."** Transmeton Ahmed. Prej këshillës për Allahun është të duash atë që e do Allahu prej fjalëve dhe veprave dhe të urresh atë që Allahu e urren. Disa prej dijetarëve kanë thënë: Këshilla është t'i japësh rëndësi me zemër atij që këshillon e kjo është dy llojshe: Njëra prej tyre është detyrë e tjetra është e pëlqyer. Këshilla e detyruar për Allahun e Madhëruar është interesi i madh që tregon personi duke e dashur Allahun gjatë zbatimit dhe kryerjes së detyrave ndaj Tij si dhe largimi nga ato që Ai i ndaloj. Ndërsa këshilla e pëlqyer është dhënia përparësi dashurisë së Allahut ndaj dashurisë për veten e kjo duket nëse personi ka përpara dy çështje, njëra ka përfitim për veten ndërsa tjetra është punë për hir të Allahut, atëherë i jep përparësi asaj që është për hir të Allahut. Ndërsa këshilla për librin e Allahut është ta duash atë, madhërimi i tij, dëshira për ta kuptuar atë, dhënia rëndësi mësimi të tij sipas mundësisë dhe suksesit që të jep Allahu, vazhdimësia në leximin e tij, sjellja sipas moralit të tij, gjykimi tek ai dhe thirrja e njerëzve për ta mësuar atë dhe për tua mësuar atë të tjerëve. Ndërsa këshilla për të dërguarin e Allahut është bindja ndaj urdhërave të tij, largimi nga ato që ai ndaloj, besimi në atë që ai na lajmëron, adhurimi i Allahut sipas Sheriatit të tij, ndihmesa e Sunnetit të tij, kujdesi për udhëzimin që ai solli dhe shpërndarja e tij si dhe urrejtja e atyre që e urrejnë Sunnetin e tij, pasimi i tij shfaqurazi dhe fshehtazi, dashuria e tij më shumë sesa vetja, pasuria, familja dhe fëmijët, kundërpërgjigjia që dijetarët i bëjnë pasimit të epsheve që çojnë në humbje, ruajtja e Sunnetit dhe mbrojtja e tij. Ndërsa këshilla për prijësat e muslimanëve shprehet në lutjen për mirësinë e tyre dhe shpresa që ata të rregullohen, të duash drejtësinë e tyre dhe bashkimin e njerëzve rreth tyre, përhapja e të mirave të tyre dhe urrejtja e përmendjes së të këqijave të tyre, bindja ndaj tyre në të mirë, mos dalja kundër tyre qoftë me fjalë ose me vepra si dhe urrejtja e atyre që duan të dalin kundër tyre, këshilla e tyre me mënyrën më të mirë në ato çështje që i sjellin mirësi popullit në dynja dhe Ahiret, këshillimi i tyre të bëhet me butësi, mençuri, për hir të Allahut, mos të lutemi kundër tyre. Ndërsa këshilla për njerëzit e

thjeshtë plotësohet duke dashur për ta atë që do edhe për vete, të urresh për ta atë që urren edhe për vete, të mëshirosh të voglin, të respektosh të madhin, ndihma e tyre në të vërtetën dhe mësimi i tyre, urdhërimi i tyre për të mirë dhe ndalimi i tyre nga e keqja, largimi i së keqes dhe rrezikut që i kërcënon ata. Nga rreziqet dhe të këqijat më të mëdha që po ndodhin mbi këtë popull janë veprimet shkatërruese, terroriste që e bënë të lejuar derdhjen e gjakut të ndaluar, shkatërrimin e pasurive, frikësimin e njerëzve të qetë dhe të cilat u bënë shkak për prishjen e rendit dhe qetësisë. Këto veprime e kanë origjinën nga mendimi i tekfirit (nxjerrjes së muslimanëve nga feja) dhe i Hauarixhëve i cili nuk sjell veçse shkatërime në tokë. Këtë mendim Muhammedi alejhis-selam e ka përçmuar. Prej këshillës për njerëzit e thjeshtë muslimanë është largimi i këtij mendimi prej tyre dhe paralajmërimi i muslimanëve prej tij si dhe lajmërimi i organeve përkatëse për ata persona që pregatiten për shkatërime të tilla që kështu ata të gjejnë shpërblimin e merituar dhe që të largohet rreziku i gjakderdhjet të mëtejshme si dhe i shkatërrimit të pasurive. Nuk lejohet fshehja e tyre në asnjë mënyrë. Prej këshillës për muslimanët është mbrojtja e tyre nga çdo e keqe në fenë dhe dynjanë e tyre. Dijeni se Hauarixhët shkatërrojnë fenë dhe dynjanë. Allahu i madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) Allahut dhe të Dërguarit kur ai (i Dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, dhe dijeni se Allahu ndërhyt mes njeriut dhe zemrën së tij dhe (dijeni) se ju do të toboheni tek Ai."** (El-Enfal: 24)

O ju muslimanë! Tregohuni të devotshëm ndaj Allahut dhe frikësojuni asaj dite kur do të ktheheni tek Allahu, pastaj secili do të shpërblehet sipas veprave që ka bërë dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi. Zbatojeni porosinë që Muhammedi alejhis-selam ia dha Muadhrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!): **"Frikësoju Allahut kudo që të jesh, pasoje të keqen me një të mirë që ta fshijë atë dhe sillu me njerëzit me moral të mirë."** Për çdo të mirë ka shpërblim dhe për çdo të keqe ka ndëshkim. Zoti juaj është mbikqyrës për punët e gjithkujt, ua numëron punët krijesave pastaj i gjykon për to dhe në një hadith kudsî thotë: **"O robërit e Mi, ato janë punët tuaja, ua llogaris ato e pastaj ju shpërblej për to. Kush gjen mirë le të falenderojë Allahun e kush gjen diçka tjetër (jo të mirë) mos të qortojë veçse veten e tij."** Çdo njeri do ta marrë librin e (punëve të) tij ose me të djathtën ose me të majtën. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"Secilit njeri ia kemi ngjeshur në qafë fluturaken (librin për punën) e tij, e në ditën e Kijametit Ne do t'i nxjerrim atij një libër të hapur. (Do t'i thuhet) Lexoje librin tënd, mjafton të jesh sot vetë llogaritës i vetvetes."** (El-Isra: 13-14) Pregatituni për këtë ditë me çdo gjë të mirë që keni mundësi. **"Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, lavdërojeni atë (duke bërë salavate për të) dhe përshëndeteni me selam."** (El-Ahzab: 56)

www.alharamainonline.org